



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**PROJEKTLIGJ**

**Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8417, DATË 21.10.1998 “KUSHTETUTA E  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 83, pika 1 dhe 177 të Kushtetutës, me propozimin e më shumë se një të pestës së anëtarëve të Kuvendit,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Neni 64 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 64**

1. Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur me sistem proporcional me zona zgjedhore shumëemërore.
2. Zona zgjedhore shumëemërore përputhet me ndarjen administrative të një prej niveleve të organizimit administrativo-territorial.
3. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor proporcional, përcaktimin e zonave zgjedhore dhe për numrin e mandateve për secilën zonë, përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.

## **Neni 2**

Neni 65 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 65

1. Kuvendi zgjidhet çdo 4 vjet. Mandati i Kuvendit fillon me mbledhjen e parë të tij pas zgjedhjeve dhe përfundon në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të katërt nga data e mbledhjes së parë. Në çdo rast, Kuvendi qëndron në detyrë deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri të zgjedhur.
2. Zgjedhjet për Kuvendin e ri zhvillohen në periudhën zgjedhore më të afërt që i paraprin datës së përfundimit të mandatit të Kuvendit. Periudhat zgjedhore dhe rregullat për thirrjen e zgjedhjeve për Kuvendin përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.
3. Në rast shpërndarjeje të Kuvendit para përfundimit të mandatit të plotë, zgjedhjet thirren jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së tij.
4. Kuvendi nuk mund të nxjerrë ligje gjatë periudhës 60 ditë para mbarimit të mandatit të tij, deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri, me përjashtim të rasteve të vendosjes së masave të jashtëzakonshme.”

## **Neni 3**

Nenin 67 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 67

1. Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e porsazgjedhur jo më parë së data e përfundimit të mandatit të Kuvendit paraardhës, por jo më vonë se 10 ditë pas mbarimit të këtij mandati. Kur Kuvendi paraardhës është shpërndarë para mbarimit të mandatit, Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e ri jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.
2. Në rast se Presidenti i Republikës nuk e ushtron këtë kompetencë, Kuvendi vetëmbledhet në ditën e dhjetë të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

## **Neni 4**

Neni 68 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 68

1. Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike, koalicionet zgjedhore të partive politike, si dhe nga zgjedhësit. Një kandidat mund të paraqitet vetëm për një nga subjektet propozuese sipas kësaj pike. Renditja e kandidatëve për deputetë në listat shumëemërore nuk mund të ndryshohet pas

- paraqitjes së listës në komisionin zgjedhor përkatës. Rregullat për regjistrimin e kandidatëve për deputetë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.
2. Në ligjin për zgjedhjet përcaktohen edhe kritere dhe rregulla të tjera të nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, duke përfshirë ato për regjistrimin e zgjedhësve, zhvillimin e fushatës zgjedhore, administrimin, vlefshmërinë e zgjedhjeve dhe shpalljen e rezultateve të tyre.”

## **Neni 5**

Neni 87 ndryshohet si më poshtë:

### “Neni 87

1. Kandidati për President i propozohet Kuvendit nga një grup prej jo më pak se 20 deputetësh. Një deputet nuk lejohet të propozojë në të njëjtën kohë më shumë se një kandidat.
2. Presidenti i Republikës zgjidhet me votim të fshehtë dhe pa debat nga Kuvendi. Për zgjedhjen e Presidentit, Kuvendi zhvillon deri në pesë votime.  
Votimi i parë zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga fillimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit. Secili nga votimet e tjera zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga përfundimi pa sukses i votimit pararendës. Votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat. Në votimin e dytë, të tretë dhe të katërt mund të paraqiten kandidatë të rinj, sipas kushteve të pikës 1 të këtij neni.
3. Presidenti zgjidhet në votimin e parë, të dytë ose të tretë kur një kandidat merr jo më pak se tri të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në votimin katërt dhe të pestë, zgjidhet President kandidati që siguron më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
4. Votimi i pestë zhvillohet kur në votimin e katërt asnjë kandidat nuk ka siguruar shumicën e kërkuar të votave. Votimi i pestë zhvillohet vetëm midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në votimin e katërt. Në rast se ka më shumë se dy kandidatë me të njëjtin numër votash, kandidati që merr pjesë në votim caktohet me short.  
Në rast se pas votimit të katërt nuk ka mbetur asnjë kandidat në konkurrim, për këtë votim mund të paraqiten kandidatë të rinj, sipas kushteve të pikës 1 të këtij neni. Kur paraqiten më shumë se dy kandidatë, votimi zhvillohet midis dy kandidatëve që kanë siguruar numrin më të lartë të deputetëve propozues.
5. Në rast se edhe pas votimit të pestë asnjë kandidat nuk siguron shumicën e kërkuar, ose kur pas votimit të katërt pa sukses, nuk paraqitet asnjë kandidaturë e re, Kuvendi shpërndahet. Zgjedhjet e reja zhvillohen brenda 45 ditëve nga shpërndarja e tij.
6. Kuvendi pasardhës e zgjedh Presidentin e Republikës me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij.”

## **Neni 6**

Në nenin 88 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 2 riformulohet si më poshtë:

“2. Mandati përfundon në të njëjtën datë, të të njëjtit muaj të vitit të pestë nga data e betimit si President i Republikës. Mandati i Presidentit zgjatet vetëm në kohë lufte dhe për aq kohë sa vazhdon ajo.”

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Procedura për zgjedhjen e Presidentit fillon jo më vonë se 60 ditë para mbarimit të mandatit presidencial paraardhës. Kur mandati presidencial përfundon në gjashtë muajt që i paraprijnë fundit të mandatit të Kuvendit ekzistues, procedura për zgjedhjen e Presidentit fillon jo më vonë se 60 ditë para mbarimit të mandatit të Kuvendit.”

### **Neni 7**

Neni 104 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 104

1. Kryeministri ka të drejtë t’i paraqesë Kuvendit mocion besimi ndaj Këshillit të Ministrave. Në rast se mocioni i besimit votohet nga më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, Kryeministri, brenda 48 orësh nga votimi i mocionit, i kërkon Presidentit të Republikës shpërndarjen e Kuvendit.
2. Presidenti shpërndan Kuvendin brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës. Kërkesa për mocion besimi nuk mund të paraqitet gjatë periudhës së shqyrtimit të mocionit të mosbesimit sipas nenit 105.
3. Votimi i mocionit nuk mund të bëhet pa kaluar tri ditë nga paraqitja e tij.”

### **Neni 8**

Neni 105 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 105

1. Një e pesta e deputetëve ka të drejtë të paraqesë për votim në Kuvend një mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit në detyrë, duke propozuar një Kryeministër të ri.
2. Kuvendi mund të votojë një mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit vetëm duke zgjedhur me votat e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij një Kryeministër të ri.
3. Presidenti i Republikës dekreton shkarkimin e Kryeministrit në detyrë dhe emërimin e Kryeministrit të zgjedhur, jo më vonë se 10 ditë nga votimi i mocionit në Kuvend.”

### **Neni 9**

Në nenin 149 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 riformulohet si vijon:

“1. Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit, për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë riemërimi.”

b) Pika 4 ndryshohet si vijon:

“4. Prokurori i Përgjithshëm raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit.”

### **Neni 10**

Pjesa 12 e Kushtetutës “Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve”, shfuqizohet.

### **Neni 11**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**

**Jozefina Topalli (Çoba)**

## RELACION SHPJEGUES

**Për tekstin e integruar të amendamenteve të miratuara në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

### **PËR PROJEKTLIGJIN PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8417, DATË 21.10.1998 "KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", E NDRYSHUAR**

Projektligji për disa ndryshime në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, vjen si domosdoshmëri e përmirësimit të kryerjes së zgjedhjeve në Shqipëri. Aktualisht janë disa nene në Kushtetutë që rregullojnë në mënyrë parimore sistemin e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës. Konkretisht janë nenet 64, 65, 68, 153 dhe 154, që në mënyrë të drejtpërdrejt kanë fiksuar mënyrën e zgjedhjes së deputetëve dhe administrimin e zgjedhjeve në Shqipëri.

Raportet ndërkombëtare të monitorimit të zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri, që prej vitit 2001 e në vijim, kanë theksuar qartazi nevojën për një sistem zgjedhor të thjeshtë dhe më përfaqësues për Shqipërinë. Këto raporte në mënyrë sistematike kanë sugjeruar korrektimin e disa mangësive që vijnë prej konceptimit dhe zbatimit të gabuar të sistemit zgjedhor në Kushtetutë.

Nga ana tjetër, aktorët politikë në Shqipëri kanë hedhur vijimisht idenë e ndryshimit të sistemit zgjedhor drejt përmirësimit të tij.

Pavarësisht nga pikëpamjet, konceptet apo modelet që ekzistojnë apo zbatohen, një sistem i përmirësuar në thelb duhet të synojë :

1. një sistem përfaqësimi politik real në vendimmarrjen e pushtetit legjislativ;
2. dhënien fund trafikimit apo deformimit të votës në çdo formë që ajo të shfaqet;
3. shtensionimin e proceseve zgjedhore dhe shmangien e disa dukurive të jashtëligjshme që e shoqërojnë atë;
4. thjeshtimin e procesit të votimit, ndarjes së mandateve ndërmjet fituesve dhe nxjerrjen sa më shpejt të rezultateve zgjedhore;
5. garantimin e stabilitetit të qeverisjes;
6. përfaqësimin më të drejtë të grave dhe të grupeve të marginalizuara në legjislativ.

Zbatimi në praktikën shqiptare i sistemit maxhoritar për 100 zonat elektorale në vend, ka nxjerrë në pah shumë nga problemet negative. Një sistem i pastër maxhoritar apo edhe një modifikim i tij, ka pak gjasa të sjellë përmirësime të theksuara në përfaqësim apo një përfaqësim më të drejtë, përveçse një tendencë për të pasur më shumë qëndrueshmëri në qeverisje, por që në mënyrë integrale mbartin edhe rrezikun për "supershumica" parlamentare duke rrezikuar shumë marrëdhëniet delikate kushtetuese në vend.

Në gamën e modeleve elektorale të sistemit proporcional, sistemi më i përshtatshëm për kushtet e vendit tonë, dhe që zbut anët e dobëta të përfaqësimit proporcional mund të jetë sistemi proporcional rajonal, pra në zona zgjedhore shumëëmërore. Ky model i zgjedhjeve duket se adreson pjesën më të madhe të objektivave të përmendura më sipër, por njëkohësisht zbut edhe një nga elementet më të dobët të sistemit proporcional, atë të shkëputjes nga zgjedhësi dhe krijimin e elitave të shkëputura politike. Zgjedhja e deputetëve nga lista shumëëmërore e ruan lidhjen e elektoratit me të zgjedhurit në zonën elektorale, realizon një shpërndarje më të larmishme ndërmjet forcave politike në të gjithë territorin e vendit, si dhe siguron një përfaqësim më të drejtë ndërmjet votës së hedhur dhe ndarjes së mandateve në Kuvend.

Projektligji fut në parim sistemin proporcional rajonal, i cili në mënyrë të detajuar do të rregullohet në Kodin Zgjedhor. Është Kodi Zgjedhor instrumenti i duhur ligjor që i jep sistemit nuancat e duhura në raport me nevojat që ka vendi dhe/ose konsensuset politike të nevojshme që do të mbështeten nga shumica e cilësuar, që kërkon miratimi i ligjit zgjedhor.

Neni 1 i këtij projektligji, bën riformulimin e nenit 64 të Kushtetutës, dhe përcakton sistemin proporcional rajonal me zona shumëëmërore si model për realizimin e zgjedhjeve të përgjithshme në vend. Gjithashtu në këtë dispozitë bëhet edhe një harmonizim i shtrirjes territoriale të zonës zgjedhore me një nga njësitë e ndarjes territoriale të përcaktuara në Republikën e Shqipërisë dhe më konkretisht në nenin 108 të Kushtetutës.

Ndryshimet në nenet 65 dhe 67 të Kushtetutës (nenet 2 dhe 3 të projektligjit), vijnë si rrjedhojë e ndryshimit të sistemit zgjedhor në nenin 64 dhe synojnë saktësimin e fillimit të mandatit të Kuvendit, të mbledhjes së parë të Kuvendit të ri, si kohën kur duhet të fillojë periudha zgjedhore në të cilën do të zhvillohen zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e ri.

Në nenin 4 projektligji ndryshon nenin 68 të Kushtetutës, duke synuar një delegim sa më të plotë të çështjeve që duhet të rregullojë ligji zgjedhor, të tilla si rregullat për caktimin e kandidatëve, për regjistrimin e zgjedhësve, për zhvillimin e fushatës zgjedhore, administrimin, shpalljen e rezultateve dhe vlefshmërinë e zgjedhjeve etj.

Shfuqizimi i kreut 12 të Kushtetutës që vjen si propozim i ri në nenin 10 të projektligjit ka për qëllim kalimin e këtij institucioni nga institucion kushtetues në një institucion të pavarur të rregulluar me ligj të veçantë. Duke qenë se amendimi i Kushtetutës në vitin 2007 vetëm për të ndryshuar numrin e anëtarëve të KQZ-së nga 7 në 9, mori pamje të politizuar, kalimi i këtij institucioni në ligjin zgjedhor do të shmangë ndërhyrjet për arsye politike në Kushtetutë dhe do t'i japë këtij institucioni mundësinë të organizohet dhe të veprojë në varësi të ndryshimeve të legjisllacionit për zgjedhjet që zhvillimi i vendit mund të sjellë në vitet në vijim.

Gjithashtu, kjo nismë kushtetuese përmban edhe disa propozime që kanë të bëjnë me amendimin e neneve të tjera të Kushtetutës, të cilat në vijimësi janë bërë objekt

debatesh publike dhe politike dhe për të cilat edhe organizmat ndërkombëtare në rekomandimet e herëpashershme të tyre kanë sugjeruar të përmirësohen.

Kështu, përse i përket procesit të zgjedhjes së Presidentit të Republikës me qëllim për të shmangur krizat politike dhe institucionale të panevojshme, të cilat do të çonin në zgjedhje të parakohshme, neni 5 i projektligjit propozon që neni 87 të ketë një formulë të re për zgjedhjen e Presidentit. Propozimi parashikon që zgjedhja e Presidentit me 5 votime të ndahet në 3 votime me 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit dhe 2 votime të fundit me shumicë absolute. Ndryshimi i këtij neni nuk çënon frymën e Kushtetutës për të zgjedhur një President me një konsensus sa më të gjerë dhe me legjitimitetin e duhur. Duke qenë se në dy votimet e para kërkohet shumica prej 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, kjo i jep mundësi edhe partive të opozitës që të marrin pjesë në proces në mënyrë aktive dhe të bëhen pjesë e vendimmarrjes. Mekanizmi për të kaluar pas disa tentativash të pasukseshme nga një shumicë e cilësuar me 3/5 e deputetëve në një shumicë më të ulët (shumicë absolute apo të thjeshtë) përdoret edhe në Kushtetutat e Gjermanisë, Italisë, Greqisë, Turqisë, Çekisë, etj. Kjo bëhet për të shmangur krizat e zgjatura të institucioneve që çojnë në destabilizim të pushteteve legjislative e egzekutive, me pasojë negative në zhvillimin e vendit dhe jetën e qytetarëve.

Ndryshimet e propozuara në nenin 88 të Kushtetutës (neni 6 i projektligjit), kanë për qëllim të vetëm saktësimin e fillimit të procedurave për zgjedhjen e Presidentit, si dhe qartësimin e periudhës së përfundimit të mandatit të tij, për të mos lënë shkak për keqinterpretime kushtetuese.

Amendimi i neneve 104 dhe 105 të Kushtetutës (nenet 7 dhe 8 të projektligjit), që ka të bëjë me mocionin e besimit të Kryeministrit të vendit dhe me mocionin e mosbesimit të paraqitur nga 1/5 e deputetëve dhe synon shmangien e krizave institucionale që vijnë si rezultat i presioneve politike të koalicioneve qeverisëse dhe rritjen e efektshmërisë së qeverisjes. Instituti i mocionit të besimit do të shërbejë si element kompaktësues për një mazhorancë të ngritur mbi bazë koalicioni, pasi rreziku i zgjedhjeve të parakohshme në rast humbje të mocionit mund të ndihmojë stabilitetin e koalicionit, pra dhe të qeverisjes së vendit. Propozimi i konceptimit të ri bashkëkohor për nocionin konstruktiv të mosbesimit do të krijojë një klimë stabiliteti në qeverisje. Kjo nuk përjashton të drejtën e opozitës për të iniciuar një mocion mosbesimi sipas konceptimit klasik të këtij instrumenti.

Neni 9 i projektligjit që ndryshon nenin 149 të Kushtetutës vendos që Prokurori i Përgjithshëm të ketë një mandat ligjor të përcaktuar për kohëzgjatjen e qëndrimit, duke e sjellë edhe institucionin e Prokurorit të Përgjithshëm në të njëjtën linjë me të gjitha institucionet e tjera kushtetuese të cilat kanë mandate të përcaktuara. Vendosja e kësaj dispozite vjen pas një debati të gjatë të politikës shqiptare dhe ndërgjegjësimit të opinionit të përgjithshëm për domosdoshmërinë e parashikimit të një mandati ligjor për Prokurorin e Përgjithshëm.

Si deputetë të grupeve të ndryshme politike, të shumicës dhe opozitës, ne besojmë se këto amendime do t'i shërbejnë stabilitetit të institucioneve, një qeverisjeje më të mirë



të vendit dhe realizimit të proceseve integruese të Shqipërisë. Paraqitja e këtyre amendamenteve është bërë në përputhje me procedurat kushtetuese dhe Rregulloren e Kuvendit.

Është Kuvendi ai që me votimin prej 2/3 të të gjithë anëtarëve të tij do të votojë dhe vendosë për këto amendamente të propozuara.